
**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“INTERNATIONAL BUSINESS TRADE” Sh.p.k.**

**AKT- THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“INTERNATIONAL BUSINESS TRADE” Sh.p.k.**

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve themelues te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **“INTERNATIONAL BUSINESS TRADE” Sh.p.k.** dhe me emer tregtare **“INTERNATIONAL BUSINESS TRADE”**, zoterohet nga ortaku:

- 1. Z. Antonino Terrazzino, shtetesi italiane, lindur ne Agrigento (AG) me 18.08.1962, i identifikuar nepermjet kartes se identitetit me numer CA51526CA.**

Në përputhje me vullnetin e tij te lirë dhe bazuar ne dispozitat e legjislacionit shqiptar, vendosi të hartojnë këtë akt themelimi të shoqërisë **“INTERNATIONAL BUSINESS TRADE” Sh.p.k.** mbi bazen e ketyre principeve:

**NENI 1
FORMA DHE EMRI**

Shoqëria ka formen e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me initiale SH.P.K., dhe i perballon humbjet deri ne kufirin maksimal te vleres se kontributit te ortakeve ne kapitalin themeltar. Emri i shoqerise **“INTERNATIONAL BUSINESS TRADE” Sh.p.k.**

**NENI 2
BAZA LIGJORE**

Shoqëria është themeluar dhe do të funksionojë në përputhje me ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007, Ligji me Nr.9901, datë 14.04.2008 në përputhje me legjislacionin shqiptar në përgjithësi, në përputhje me aktet e shoqërisë si dhe në përputhje me marreveshjet nderkombetare te ratifikuara dhe qe do te ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërisë.

**NENI 3
SELIA**

Selia e shoqerise eshte ne adresen: Rruga Tefta Tashko Koco, Pallati 20, Hyrja 14, Apartamenti 10, Tirane.

Në adresën e mesiperme do të identifikohet qendra e personit juridik.

Me vendim te asamblese, mund të hapen dege, filiale, agjensi ose perfaqësi brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqiperise sipas fushave ne te cilat e ushtron veprimtarine shoqëria.

NENI 4
KOHEZGJATJA DHE PRISHJA E SHOQERISE

Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj për një afat të pa përcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit ne organin kompetent. Shoqëria prishet dhe kalon në procedure likuidimi, sipas rasteve te parashikuara me ligj.

NENI 5
OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqeria " **INTERNATIONAL BUSINESS TRADE** " sh.p.k është e organizuar ne formen e nje shoqerie qe merret me:

- a) Zgjidhje dhe inovacione për kompanitë, logjistikë, konsulencë biznesi, softuer, përfaqësi, ndërmjetësim tregtar, pasuri të paluajtshme dhe transaksione tregtare në përgjithësi.

NENI 6
KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërise është 5,000 EURO (PESE MIJE EURO), i cili sipas kursit te kembimit te Bankes se Shqiperise, 107.87 ka nje vlere ne 539,350 leke, i ndare në 1 (nje) pjese. Kapitali themeltar i shoqërise zoterohet nga:

- **Z. Antonino Terrazzino nje kuote te barabarte me 100 %** - 539,350 Lekë (pese qind e tridhjete e nente mije e treqind e pesedhjete).

Kapitali themeltar i shoqërise do të shlyet tërësisht dhe depozitohet ne nje llogari të hapur në emër të shoqërise në një nga bankat e nivelit të dyte.

NENI 7
AKTET E SHOQERISE

Shoqeria do te rregullohet, pervec ketij akt-themelimi edhe me norma te percaktuara ne statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga ortakët e shoqërise dhe si i tillë do të miratohet në ditën e regjistrimit si person juridik në Republikën e Shqipërise.

NENI 8
ORGANET DREJTUESE

Organet drejtuese të shoqërise do të jenë Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve dhe Administratori. Shoqëria mund të emëroj më shume se një administrator edhe pse nuk është ortak. Në çdo rast, kur termi “Administrator” përdoret për të përcaktuar administratorët e shoqërise “**INTERNATIONAL BUSINESS TRADE**” Sh.p.k., ky term nënkupton të gjithë administratorët e saj sado qofshin këta në numer. Përveç organeve të parashikuara më sipër asambleja e ortakëve mund të krijojë edhe organe të tjera drejtuese, në aktet e krijimit të këtyre organeve do të përcaktohen kohezgjatja dhe kompetencat e tyre. Administrator i shoqërise për një periudhë 5 (pese) vjeçare, është emëruar:

Z. Antonino Terrazzino, te cilit i besohen të gjitha fuqite e administrimit të zakonshem dhe të jashtëzakonshem dhe të identifikuar me kartë identiteti Nr. **CA51526CA**.

NENI 9
DISPOZITAT E FUNDIT

Çdo mosmarrveshje a konflikt në lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likuidimin e kësaj shoqërie, ortakët do angazhohen se do të zhgjidhin me mirëkuptim, dhe në rast se kjo nuk arrihet kompetente për gjykimin e mosmarrveshjeve a konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësorë Tirane.

Ky akt themelim është hartuar në 4 (kater) ekzemplare, 2 (dy) në gjuhën shqipe dhe 2 (dy) në gjuhën italiane duke patur secili ekzemplarë fuqi të njëjtë ligjore.

Tirane, 16/07/2023

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE
Antonino Terrazzino

